

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Urgjenca për hetim mbi keqpërdorimin e SHISH-it ndaj armiqve të partisë!
ADRESA	https://www.cna.al/aktualitet/urgjenca-per-hetim-mbi-keqperdorimin-e-shish-ndaj-armiqve-te-partise-i475168
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 10:49:37 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 10:36:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	04db99ac58a013606abc0ad84abcd9ab521301b175419adaea5f50a5029ce586
TEKSTI	04bc4b5cd8ea45be759045c653fdc4490424bb91b368e6df7aacdb3099d8a010
PAMJA	77d72ed37145f22f2fada69e69136aa130ccabc80843ac7a3eb2bb4b5539bebd

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	153607720dd0ababc0a003f809e61a1ff884770353743e70cf170be29149630f
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9f67fd8f5341aacd98433415ae2bd1fabd75d8584ec60b7ea3d19ca47caca387
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/153607720dd0ababc0a003f809e61a1ff884770353743e70cf170be29149630f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

12:43 Aktualitet

Zëdhënësja për Antikorrupsionin në Partinë Demokratike, Ge...

Urgjenca për hetim mbi keqpërdorimin e SHISH-it ndaj armiqve të partisë!



25 Shtator 2026, 12:36, Aktualitet CNA



Nënkryetari i PD-së, Belind Këlliçi, e konsideron urgjent hetimin mbi keqpërdorimin e SHISH-it për kundërshtarët e kryeministrit Edi Rama dhe partisë që ai drejton.

Në këtë pikë, Këlliçi sjell në vëmendje rastin e një dite më parë me shantazhin e hapur ndaj gazetares Klodiana Lala.

Sipas nënkryetarit të PD-së, kjo tregon se ka dyshim se SHISH-i është keqpërdorur për të intimiduar kundërshtarët e kryeministrit Edi Rama, rebelët e mundshëm brenda partisë, kritikët në media, përfaqësues të Opozitës, apo edhe të protestës, të cilët janë gjithnjë në përgjim prej më shumë se 100 ditësh.

Këlliçi deklaroi se SHISH ka qenë një mashë në duart e Kryeministrit dhe rrethit të tij të ngushtë, një kamxhik sa herë u është dashur e kanë qenë në hall.

“Urgjenca për hetim mbi keqpërdorimin e SHISH ndaj armiqve të partisë!

Dezaktimi skandaloz i Vlera Hysenit ndaj gazetares Klodiana Lala, shantazhi i hapur ndaj saj, na cilloin në vëmendje atë që është thënë e denoncuar

keqpërdorim i Vlorë Hyseni nga gazetari Kujtim Lala, shprehja e urrejtjes së tij, nëse jo vetëm ajo që është akuzë e denoncimi për keqpërdorimin e SHISH për interesa politike nga Kryeministri dhe rrethi i tij i ngushtë.

Vlora Hyseni, e akuzuar për krime të rënda, në dyert e GJKKO, me gojën e vet e konfirmoi se ata kanë përgjuar e survejuar kundërshtarë, kritikë, apo njerëz që guxojnë të ngrenë zërin. Qoftë edhe duke sajuar dosje për ta.

Gazetarja investigative mund të jetë bërë bezdi jo vetëm për pushtetin por edhe për grupe kriminale. Dhe Vlora e Gysit në këtë rast, është hedhur në sulm.


Nuk ka dyshim se SHISH është keqpërdorur ndoshta masivisht për të intimiduar kundërshtarët e Edi Ramës, rebelët e mundshëm brenda partisë, kritikët në media, përfaqësues të Opozitës, apo edhe të protestës të cilët janë gjithnjë në përgjim prej 100 e ca ditësh.

Pra ka qënë një mashë në duart e Kryeministrit dhe rrethit të tij të ngushtë, një kamzhik sa herë u është dashur e kanë qënë në hall.

Kështu gjendemi para një krimi të rëndë edhe kushtetues dhe një veprimtari e tillë e errët duhet hetuar deri në fund.

Vlora Hyseni kishte kontroll të plotë mbi institucion, aq sa nën mandatin e saj nuk pati as nëndrejtor, që gjithnjë ka shërbyer si një lloj garancie kur titullari çmendet ose rrëshket në paligjshmëri.

Në këto rrethana, ka qënë edhe më e lehtë të keqpërdoret institucioni që duhet të shërbejë për sigurinë kombëtare, për të luftuar krimin e korrupsionin”, shkruan Këlliçi./ CNA





Kush ishte Zai Fundo?

Të sugjeruara

E dredh partizan Sadushi, i nënshtrohet Ramës

Shantazhi i Hysenit ndaj Klodiana Lalës/ Deputetja e PS-së-SPAK-ut: Me përparësi kallëzimi i gazetares

Maks Haxhia rrezikon burgun/ Ka marrë "peng" GJKKO-në

Sot zgjidhen tre anëtarët e rinj të KLGJ-së/ 7 kandidatët në garë

"I kanë fikur radarin"/ Publikohet videoja, rrihet në mes të rrugës shefi i Komisarariatit

Zyrtarët e lartë dhe krimi i organizuar u bënë njësh në mbrojtje të Ergys Agasit

Ish-deputeti i Lulit mbledh firma për Erion Veliajn

VIDEO-Rama pritet me protestë në New York, protestuesit e gjuajnë me vezë

Aeroporti i Vlorës/ Pacolli, apel mediave dhe opinionistëve

Shenjtëria e tij Patriarku Ekumenik vizitoi Mbretin Charles III

Skandali i SHISH/ Paralajmërimi i gazetarit: Do ketë prapë të tjera

"Kumbari i emërimit të Vlorë Hysenit"/ Deklarata e Berishës, përgjigjet gazetari

"Meriton të rrihesh siç të rrihte Buzhala"/ Përplasja e ashpër mes Lalës dhe analistit

Shqiptari pranon fajësinë në SHBA për vjedhjen e identitetit të amerikanëve

"Ku është presidenti?"/ Beçi: Piramida e sigurisë së shtetit ka rënë

"Skandali i Vlorë Hysenit nuk është histori rozë"/ Lala: Është dosja më e rëndë që ka pasur SPAK

Skandali i Hysenit/ Shkullaku: Arrestimi i shefit të SHISH, më i rëndë se arrestimi i kryeministrit

Shantazhi nga Hyseni/ Lala: Do të përballemi në proces penal, po ndërmerren hapa dhe në Britani

“Territorialja”/ Këshilli Bashkiak i Elbasanit voton pro bashkimit me Cërrikun dhe Belshin


Kërkohet dorëheqja e Ramës/ Nis protesta e 117 kundër qeverisë

[editorial](#)

09:11 Editorial Bujar Leskaj

Të ndihmojmë SHISH-in të mbrojë shtetin nga krimi, dhe jo krimin nga shteti!!

CNA LIVESTREAM



Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

[opinion](#)

14:39 Opinione Ylli Dylgjeri

VLORE MOJ NUR I PUSHTETIT

12:05 Opinione Luan Dama

Skandal pas skandali/ Një palo shtet anëtar i NATO-s

20:06 Opinione Grigels Muçollari

Po tani, kush do ta shpëtojë Shqipërinë nga turpërimi?!

Lifestyle

19:00 Lifestyle

Llumi i kafesë me uthull, ja truku praktik për pastrimin e kuzhinës

Një truk praktik dhe ekonomik pastrimi përfshin përdorimin...